

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	DW - BE-ja nuk bojkoton samitin e G20-së pas ftesës për Putinin
ADRESA	https://www.syri.net/bote/919489/be-ja-nuk-bojkoton-samitin-e-g20-se-pas-fteses-per-putin/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 12:20:33 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 11:37:37 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	2f70ee8602aded2efd0254451d96fe3cd7cef97819bb4f49b10dbb872f6
TEKSTI	07c23ceac47bd2422c437803743e2659c036e888f3d01ee94072b25169edac50
PAMJA	2ca22137b3b65522d3b1d17a3b3a839b670927fa8160d23718de0cb91378fc1f

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	b4e0700eb5bc3684b36dada168602781b2db406745592aa51bae3c14132f7a17
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	7677d8d9488aa5a9422459265187ef4d7802fbf31e13dbd8fed410ad19a65ead
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/b4e0700eb5bc3684b36dada168602781b2db406745592aa51bae3c14132f7a17>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



FATMIR MEDIU

Rama heshti për Kosovën në OKB, nuk iu kundërvu Vuçiçit dhe zgjodhi të flasë për Diellën



NDRIM KULLA

Dorëheqja e Ramës, kërkesë edhe e ndërkombëtarëve



më të lexuarat

SHBA e fton Putinin në samitin e G20-së

Për herë të parë në histori! Agjenti i AI hakeron portalin qeveritar australian, sulmi u zbulua disa javë me vonë

Rritet bilanci i viktimave amerikane në luftën me Iranin

Rodos: Makth i dyfishtë për 44-vjeçaren polake nga 28-vjeçari shqiptar: Ai i mori 15,000 euro dhe kur ajo ia kërko...

Ambasadori amerikan: Trump e paralajmëroi Xinë që të mos e mbështesë Iranin

DW/ A do ta ekstradojë Kroacia të dyshuarin për shpërthim?

14 të vdekur në Detin Kaspik. ushtarakët

BE-ja nuk bojkoton samitin e G20-së pas ftesës për Putinin

13:37, 27/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



SHBA e ftoi presidentin rus Vladimir Putin në samitin e G20-së që do të mbahet në dhjetor. BE reagoi e zemëruar, por nuk planifikon ta bojkotojë takimin, ajo ka planin e saj.

Presidenti amerikan Donald Trump e ka ftuar zyrtarisht presidentin rus Vladimir Putin në samitin e G20-së. Ftesa u përcoll nga sekretari amerikan i Shtetit, Marco Rubio, në kuadër të debatit të përgjithshëm të OKB-së në Nju Jork. Argumenti i administratës amerikane është se dialogu duhet të vazhdojë edhe me partnerë të vështirë.

Samiti i G20-së pritet të zhvillohet në dhjetor në Miami, Florida. Bashkimi Evropian është anëtar me të drejtë të plota i G20-s. Përveç kësaj, disa shtete anëtare, si Gjermania, Franca dhe Italia, marrin pjesë gjithashtu me përfaqësuesit e tyre.

BE-ja tashmë ka një plan për samitin e G20-së

Si do të reagojë Bashkimi Evropian ndaj nismës së Trumpit dhe pjesëmarrjes së mundshme të Putinit? Sipas një zëdhënësi të BE-së, Rusia mbetet anëtare e G20-s dhe ka të drejtën të marrë pjesë në këto takime. Ai shtoi se BE-ja do të vazhdojë t'i përdorë këto forume për të dënuar luftën agresive të Rusisë kundër Ukrainës, pavarësisht se kush merr pjesë në samit. Kjo do të thotë se Brukseli synon të jetë i pranishëm në Miami edhe nëse Putini merr pjesë, duke mos dashur t'ua lërë skenën Trumpit dhe Putin, veçanërisht kur në diskutim është e ardhmja e Ukrainës.

Megjithatë, ende nuk është e qartë nëse përfaqësuesit e BE-së do të jenë të gatshëm të ulen në të njëjtën sallë me Putinin. Nga shumica e vendeve anëtare të BE-së kanë ardhur reagime kritike ndaj ftesës drejtuar presidentit rus.

Diplomatët francezë: "Fronti perëndimor" është në rrezik

Pas ftesës së SHBA, Berlioni zyrtar theksoi, se nuk mund të ketë kthim në normalitet në marrëdhëniet me Rusinë pas agresionit rus ndaj Ukrainës. Qeveria gjermane u shpreh se është në dijeni për ftesën drejtuar Vladimir Putin.

Edhe kryeministria italiane, Giorgia Meloni u shpreh kritike, duke deklaruar se tani është koha të kërkohej lëshime nga Rusia, dhe jo që Putinit t'i jepet më shumë peshë diplomatike. Një aëndrim të ngjashëm mbaiti edhe qeveria franceze. Sipas

Parisi, nuk është momenti i duhur për normalizimin e marrëdhënieve me Rusinë. Megjithatë, askush nuk po flet për bojkot të samitit.

Në Paris dhe Romë theksohet se Bashkimi Evropian duhet të mbetet i bashkuar në reagimin e tij. Presidenti francez Emmanuel Macron paralajmëroi: "Asnjë vendim për Ukrainën pa Ukrainën dhe pa Evropën."

Arrestmandati i Gjykatës Penale Ndërkombëtare ndaj Putinit

Edhe në Parlamentin Evropian theksohet se nuk mund të ketë rikthim në normalitet me Vladimir Putinin. Ky duhet të mbetet qëndrimi i palëkundur i Evropës, deklaruan deputetë letonezë nga grupi i Partisë Popullore Evropiane (EPP). Ata kujtojnë krimet e luftës dhe faktin se më shumë se 20.000 fëmijë ukrainas janë deportuar nga Rusia, ndërsa deri më tani vetëm rreth 2.500 prej tyre janë kthyer në Ukrainë.

Ndaj presidentit rus Vladimir Putin është lëshuar një urdhër-arrest nga Gjykata Penale Ndërkombëtare (GJPN/GJPND). Ky është edhe një nga arsytet, pse ai nuk mori pjesë në samitet e fundit të G20-s, përfshirë atë të zhvilluar në Brazil.

Politikanët e BE-së presin që, pas sulmeve të Trumpit ndaj Gjykatës Penale Ndërkombëtare, Vladimir Putini mund të jetë i gatshëm të udhëtojë në Miami, pasi atje nuk ka arsye të frikësohet nga ndonjë pasojë ligjore. "Lufta në Ukrainë ka treguar se krimet e luftës mund të rikthehen nëse ato nuk njihen dhe nuk trajtohen siç duhet," deklaroi eurodeputetja lituaneze e Partisë Popullore Evropiane (EPP), Rasa Jukneviene.

"Një gjykatë ndërkombëtare që pengohet nga Trumpi të kryejë punën e saj legjitime duhet të jetë një sinjal alarmi për të gjithë ne," kritikoi veprimet e Trumpit ndaj Gjykatës Penale Ndërkombëtare zëdhënësi për politikën e jashtme i socialdemokratëve në Parlamentin Evropian, Yannis Maniatis. Nga ana tjetër, politikanët e AfD-së e kanë mirëpritur afrimin diplomatik mes Donald Trumpit dhe Vladimir Putinit. /DW/

© SYRI.net

Lexo edhe:



Rusia sulmon Ukrainën, Zelensky: Moska s'është e gatshme t'i japë fund luftës



Rëndohet bilanci/ 27 të vrarë në dy sulme me armë në Afrikën e Jugut



Inteligjenca artificiale kontrollon shinat në Zvicër, zbulon deri në 1,500 defekte në muaj

kazakë u përfshinë nga dallgët gjatë stërvitjes

Xi Jinping-Trumpit: Inteligjenca Artificiale duhet të mbetet nën kontrollin e njeriut

Të rinjtë në SHBA po pinë më pak alkool, por konsumi rritet te moshat mbi 50 vjeç

TË NGJASHME



Australia thërret drejtuesit e OpenAI dhe Anthropic në hetimin e Senatit për inteligjencën artificiale




27 të vrarë në dy sulme me armë në Afrikën e Jugut



Papa Leone XIV mbërrin në Lourdes, mijëra besimtarë marrin pjesë në Meshën në shenjtëroren e famshme



Rendi global po përjeton 'çarje, jo tranzicion' - paralajmëron Kanada



Kryediplomati gjerman pas takimit me Lavrovin: Është e drejtë që të flasim me njëri-tjetrin



10 të zhdukur pas orteikut në Nepal, mes tyre alpinistë dhe pjesëtarë të stafit



SHBA-ja thotë se masat e reja ekonomike ndaj Iranit janë të suksesshme



informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendojnë se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.